- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Vlerësimit;
 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 6. Preventivin e çmimeve
 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomikee detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula**

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: Sipas projekteve dhe shenimeve teknike ne projektet bashkelidhur DT.

Specifikimi i Materialeve: Sipas projekteve dhe shenimeve teknike ne anekset bashkelidhur DT dhe relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, bashkelidhur DT.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sipas projekteve dhe shenimeve teknike ne anekset bashkelidhur DT.

Shtojca 6*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***GRAFIKUT IZBATIMIT TËPUNIMEVE****Afatet e realizimit të punimeve: Sipas Grafikut te punimeve, bashkelidhur DT.**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4.						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre persiper çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2021 -2022 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet të bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatëse**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për këtë periudhë.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- situacion punimesh
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
- Akt kolaudimi;

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P - 2	B	Ndertime civile dhe industriale
N.P - 3	B	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
N.P - 12	A	Punime te inxhinerise se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S-	1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S-	2	A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S -	4	B	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
N.S –	8	A	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri
N.S –	12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S –	14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
N.S -	18	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë) ; 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme) ; 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).

Në rast bashkimi operatorësh të paktën njëri nga operatorët duhet të jetë i pajisur me Lejen e mësipërme në raport me zërat që ka marrë përsipër të kryejë;

Në rast se kjo leje nuk disponohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, AK me qëllim gjithëpërfshirjen dhe rritjen e konkurrencës do të pranojë paraqitjen e një kontrate Shërbimi nga subjektet të cilët disponojnë këtë leje.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave te çdo lloji te leshuar nga QKL. Kodi I.2.A.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në liçencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në Listëpagesat te pakten për periudhën maj-korrik 2022 si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diplomat përkatëse.

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier dokumentacion e lart përmendur.

2.3.7. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licensën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Inxhinier Mekatronik

Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diplomat përkatëse.

si dhe të figurojnë në Listëpagesat te pakten për periudhën maj-korrik 2022.

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën maj-korrik 2022 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjies per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje inxhinier si “Ekspert zjarrfikës” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certifikate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.
- 4 (kater) Punonjes Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi.D.P.I. Renia nga lartesite, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 180 (njqind e tetedhjetë) persona për periudhën maj-korrik 2022 e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën maj-korrik 2022.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën maj-korrik 2022.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Specialist Ndertimi 1(nje)
- Elektracist 7 (shtate)
- Hidraulik 3 (tre)
- Specialist te sistemit te kondicionimit ngrohes-ftohes 3(tre)
- Specialist IT 1 (nje)
- Specialist elektronik 1 (nje)
- Muratore 7 (shtate)
- Suvatues 3 (tre)
- Bojaxhinj 5 (pese)
- Punime durale 1 (nje)
- Karpentier 2 (dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Pllakashtrues 4 (kater)
- Shtrues parketi 1 (nje)
- Hidroizolues 1 (nje)
- Mekanik 1 (nje)
- Saldator 1 (nje)

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë të pakten për periudhen maj-korrik 2022 dhe në vazhdim

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) manovrator si dhe 2 (dy) shofer të mjeteve të renda.

Per manovratorët deshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten për periudhen maj-korrik 2022 dhe në vazhdim

Per shoferët leje drejtimi të vlefshme deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libereze pune dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten për periudhen maj-korrik 2022 dhe në vazhdim.

Shënim : Nese punonjesit e mesiperm nuk jane te punesuar prane shoqerise me kohe te plote per te gjithë periudhen e kerkuar, kjo perben shkak per skualifikim.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.12 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtes mbi 7 ton	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtes mbi 20 ton	copë 1	Ne pronesi ose me qera

Kamion 3.5 - 7.5ton	copë 2	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	copë 2	Ne pronesi ose me qera
Autovinc me kosh	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Autopompe betoni	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Eskavator	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Fadrom (kove para dhe krahe mbrapa)	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Rrul me vibrim	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantier	copë 3	Ne pronesi ose me qera
Matrapik 1500W	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Matrapik 1100W	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Vibrator thellesie	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Cekic pneumatik	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Saldatrice	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Skele	1500 m2	Ne pronesi ose me qera
Rrjete	1500 m2	Ne pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Pompe per lyerje	cope 1	Ne pronësi ose me qira

Mjete mbrojtese		
Kokore	186 cope	Ne pronesi ose me qera
Fikse Zjarri	10 cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela Sigurimi Teknik	40 cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	186 cope	Ne pronesi ose me qera
Kuti Ndhme e shpejt	4 cope	Ne pronesi ose me qera
Prozhektor per ndricim	2 cope	Ne pronesi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).

- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.8.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise) -ose ekuivalent
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent
- OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) ose certifikatën me standardin e azhurnuar dhe ekuivalent të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018 - ose ekuivalent
- ISO PAS 99:2012 (Per sistemin e integruartemenaxhimit)(ose e perditësuar)
- ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor)
- ISO 3834-2:2006 (Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike)
- ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Energjise)

Te gjitha Certifikatat duhet të jenë te vlefshme dhe te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

2.4.2 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Materialet e gipsit
- Materialet e rjetit ngrohes (magjistral-kolona, pultet shperndares, aparatet ngrohes)
- Materialet e sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit
- Llac,fino,koll
- Pllaka
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin(kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.4.3 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë bashkangjitur me kontraten e furnizimit/porosisë me distributorin/prodhuesin, kataloget/skodat teknike si dhe certifikatat e cilësisë të materialeve/mallrave te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente me qellim permbushjen e standarteve te kerkuara sipas specifikimeve teknike te meposhtme dhe konkretisht

Për produktet:

- **Kabull elektrik** Kabëll multipolar me mbrojtje te dyfishtë për energjinë elektrike Iizoluara me PVC,me përçues fleksibël për vendosje fikse. Tensioni U_o/U 300/500k V.Kundërzjarrit dhe me emetim të reduktuar të halogjeneve (gazeve korrozive). Izolimi sipërfaqësor I ngjyrosur.(gri) PVC e cilësisë S18 me emetim të reduktuar të halogjeneve (gazeve korrozive).Kundërzjarrit dhe me emetim të reduktuar të halogjeneve (gazeve korrozive). Klasa e reaktionit ndaj zjarrit Cca-s3-d1-a3. Temperatura minimale e instalimit dhe manipulimi 0 O C. Temperatura maksimale e punës +60 O C. Temperatura e qarkut të shkurtër (Maksimumi 5 sec) +150 O C. Seksioni nominal=3 G 1.5 mm 2 Diametri maksimal I telit = 0.26 mm Trashësia mesatare izoluese = 0.3/0.4 mm. Trashësia mesatare e guanies = 0.8/1.0 mm. Te plotesoje Standartin SSH EN 35720 :2006, ose ekuivalente.
- **Automat**; Ndërprerës termo-magnetik për kontroll, shkyçje dhe mbrojtjen e qarqeve elektrike kundër mbingarkimeve. Polarizimi 4P, Rrymat e vlerësuara në kurbën B-C-D,Kapaciteti i thyerjes: 10000 A IEC 60898-1. Tensioni dhe Frekuenca e Vlerësuar: 230 V ~ /400 V. Frekuenca 50/60 Hz. Te plotesoje Standartin IEC / EN 60898-1 ose ekuivalente.
- **Prize 2P+T/16A/ Prize bivalente 2P+T/16A** Te plotesoje standartin CEI 23-50-II ose ekuivalent
- **Tub elektrik fresibel**, te karakterizohet nga fortesia e tij, dhe fleksibiliteti.Te gjeje perdorim ne te gjitha kategorite e instalimeve elktrike. Te plotesoje Standartin EN 61386-1 ose ekuivalente.
- **Ndricues fluoreshent** certifikim ku të vërtetohet se produkti përmbush standartet europiane dhe eshte prodhim CE Te plotesoje Standartin EN 60598 ose ekuivalente
- **Tub i brinjzuar** : Për përdorim në kanalizime ujrash të bardha dhe të zeza,drenazhime, mbrojtje, etj., vendosje nen toke. Te jene te llojit SN4/ SN8. Diametri jashtem : 200 mm, Dendësia : SN4 (>=4 KN/m²), Materiali : HDPE, Gjatësia : 6 m.Tubat te jene prodhuar sipas standartit EN 13476-1 2000 dhe gominat te jene prodhuar sipas standardit EN 681 ose ekuivalente
- **Kaset + hidrant zjarri i brendshëm**. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe,me baze rezine. Dimensionet (400x600x200) mm konform En 671-22012, tub fleksibël Dn 45 konform En 14540, Aksesorët: saraqineske ndërrperëse 1½",.
- **Sirenat e alarmit per brenda dhe jashte nderteses** Sirenat e alarmit te zjarrit, me ndricues me llambe vezulluese jane te tipit inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120 dB. Sirenat e alarmit te zjarrit ne ambientet e brendshme vendosen ne lartesine H=+2.1m nga dyshemeja
- **Fikëse zjarr pluhur karelato** Bombel e lyer me boje ngjyre te kuqe (RAL 3000) e levizshme me pluhur. Mund te perdoret per fikjen e zjarrit ne pajisjet elektrike si dhe rreth tyre pasi eshte jo percielle. Efektive ne fikjen e zjarreve qe perfshin klasa B e zjarrit. Kapaciteti Normal 5kg. Dimensionet Ø 140 x 765 mm

- **Bojë Akrilike**Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike të paqëndrueshem (VOC), ku emetimi të jete jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese të bojës, ku fuqia mbuluese të jete ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj larjes. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike.
- **Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale.
- **Boje Bikomponente Paste** certifikim ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin ISO SSH: EN 12802
- **Suva (Llac mbushës)**- Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike të kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1.
- **Fino** Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike të kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1.

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.....*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), brenda afatit 5 (pesë) ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

<ul style="list-style-type: none"> • Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik 			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjisllacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
